



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 26 prill 2022, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Haki Abazi, Xhavit Haliti, Yllza Hoti, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi, Time Kadrijaj, ndërsa munguan: Branislav Nikoliq, Adelina Grainca, Ariana Musliu-Shoshi, Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani.

Në mbledhje nga Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes morën pjesë: Bekë Berisha, Enver Dugolli, Erxhan Galushi, Fatmir Humolli, Mefail Bajçinovci, Hisen Berisha, Anton Quni, ndërsa munguan: Arbër Rexhaj, Shqipe Mehmeti Selimi, Rashit Qalaj dhe Slavko Simiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Ermira Gashi, Besarta Pllana, Shkumbim Halabaku, Alma Haxhija, Faton Krasniqi, Besnik Fetahu, Arbenita Mjekiqi- Kuvendi i Kosovës, Haki Huruglica-MPJD, Jon Krasniqi-PIPS dhe media.

Nga zyrat e komisioneve: Minire Hasani, Zarë Aliu dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Haki Abazi, kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë

Rendi i ditës:

Takimi i komisionit me Komisionin për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes me temën:

- Koordinimi dhe përgatitjet për sfidat në politikën e jashtme dhe atë të sigurisë në marrëdhëniet ndërkombëtare të krijuara pas fillimit të luftës në Ukrainë.

Haki Abazi, duke ju referuar pikës së rendit të ditës theksoi se komisioni, ministria e të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë qenë agjil në nxjerrjen e Rezolutës për dënimin e agresionit rus në Ukrainë dhe përkrahjen e sovranitetit e integritetit territorial të Ukrainës, hapjes së dyerve për gazetarët dhe për heqjen e barrierave për refugjatët nga Ukraina. Ai theksoi se është e rëndësishme që sipas situatës së krijuar, të dy komisionet të fillojnë diskutimin pavarësisht faktit se si do të përfundojë ky konflikt se në çfarë dimensione mund të ketë implikime. Pasojat e luftës në Ukrainë janë shumëdimensionale për të gjithë kontinentin dhe globin në përgjithësi por edhe për rajonin tonë. Abazi vuri në pah se lufta në Ukrainë ka ardhur pas një sërë konfliktesh në botë dhe se pas rënies së murit të Berlinit, shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, shpërbërjes së ish- Jugosllavisë dhe konfliktet e hapura na shtojnë në analizë se çfarë do të thonë në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare që na prekin edhe ne, marrëdhëniet e

sigurisë dhe mbrojtjes edhe për shtetin tonë. Ndikimi që do të ketë lufta në Ukrainë dhe përmbyllja e konflikteve të hapura në sigurinë e kontinentit evropian, tha se domosdoshmërisht duhet analizuar nga institucionet tona. Si dy komisione të përbashkëta, duhet diskutuar për rrethanat e reja, ato që i dimë, e ato që nuk i dimë, se cilat janë pasojat të cilat rrjedhimisht përcaktojnë edhe prioritetet tona institucionale. Nëntema të cilat mund të bisedohen si rrjedhim i kësaj situate, tha se janë, procesi i anëtarësimit në Këshillin e Evropës, angazhimi rreth 5 vendeve mosnjohëse, forcimi i Forcës së Sigurisë dhe transformimi i saj në ushtri, procesi i anëtarësimit në NATO. Një aleancë e mundshme ballkanike si nëntemë do të mund të fillojë të diskutohet për të parë se cilat shtete të Ballkanit kanë politikë të njëjtë me NATO-n dhe të mbrojtjes në rajon si dhe marrëdhëniet dhe avancimi i tyre në raport me Shqipërinë.

Bekë Berisha, e vlerësoi të qëlluar këtë takim dhe çështjet për të cilat do të diskutohet. Janë shqetësuese zhvillimet në Ukrainë pasi ka edhe shumë viktima, gjithashtu theksoi se shqetësim është pasi sot është sulmuar Policia e Kosovës në veri, por pavarësisht kësaj përgëzoi policinë për vetëpërmbajtje, pasi sulmet duket që vijnë nga grupet kriminale të cilat janë penguar, por policia është treguar e pjekur në reagimin e saj, pasi nuk e duam Kosovën e destabilizuar. Në përmbjllje të kësaj fjale e vlerësoi pozitive organizimin e këtij takimi dhe inkurajoi që të vazhdohen takime të tilla.

Enver Dugolli, e vlerësoi organizimin e këtij takimi, marrë parasysh sfidat me të cilat është duke u përballur bota, adresimi i sfidave është i rëndësishëm, pasi Kosova ka synim anëtarësimin në Këshillin e Evropës, BE dhe NATO, për këtë arsye kërkoi që nga Komisioni për Politikë të Jashtme dhe Diasporë, në takimet që do t'i kenë të lobohet për Kosovën, me fokus anëtarësimi në mekanizmat e sigurisë, siç është Karta e Adriatikut. Anëtarësimi i plotë në këtë mekanizëm do të lehtësonte hapat për anëtarësim në NATO. Gjithashtu duhet parë me urgjencë anëtarësimi i Kosovës në PFP (Partneritetin për Paqe), për këtë kërkoi që të shtyhet përpara kjo çështje në takimet e Komisionit.

Haki Abazi, lidhur me anëtarësim në Kartën e Adriatikut pyeti se në cilin nivel jemi, çka është bërë deri më tani në këtë drejtim dhe se çka duhet bërë nga ana jonë për ta realizuar këtë objektiv.

Enver Dugolli, theksoi se për PFP-në kërkesat duhet të formalizohen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes do të duhej të dakordoheshin. Me sa ka informacion grupi ndërministrorë e ka këtë prioritet, por Komisioni të mbikëqyrë këtë proces. Ndërsa sa i përket anëtarësimit në Kartën e Adriatikut, pengesë kryesore është Bosnje e Hercegovina, ndërsa Serbia nuk është anëtare me të drejta të plota, por mund të bëjë pengesa, kjo çështje tha se duhet të ndiqet me prioritet nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Jashtme.

Hisen Berisha, ngriti disa çështje të cilat përbëjnë sfida për Kosovën, siç është anëtarësimi në Këshillin e Evropës dhe të tjera, ndërsa zhvillimet në Ukrainë kanë treguar që Kosova nuk mund të vazhdojë me status quon, por dialogu duhet të vazhdojë dhe të përmbillet me një marrëveshje finale. Kosovën e pret ratifikimi i një sërë marrëveshjeve dhe përgatitja e kuadrove. Shteti duhet të punojë në fushën e luftimit të korrupsionit, i cili ka filluar të shfaqet në politikën e jashtme. Ndërsa sa i përket ushtrisë së Kosovës, përgatitjet e saj duhet të jenë në kohë, ekonomia të fokusohet në fushën e energjetikës, kjo do të mund të bëhet me një qeveri që do të kishte përbërje të gjerë dhe stabile. Berisha theksoi se sulmet ndaj policisë së Kosovës janë të dënueshme, kjo duhet parë nëse është skenar apo sulm nga bandat e asaj ane, për këtë kërkoi që të raportohet nga ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Time Kadrijaj, theksoi se ky takim i përbashkët i dy komisioneve është një iniciativë e qëlluar e po ashtu edhe tema e cila po debatohet është e një rëndësie të veçantë, e që ka të bëjë me luftën mes Ukrainës e Rusisë, që për ne kjo situatë nuk është diçka e re. Këto skena, tha se janë në mbamendjen tonë dhe na kthejnë prapa në kohë. Kosova është rreshtuar në krah të atyre që mbrojnë vendin dhe i ka dhënë përkrahjen për atë që ka pasur mundësi meqenëse nuk është pjesë e BE-së. Ajo tha se është shumë i rëndësishëm lobimi, sidomos nga diplomacia parlamentare por për shkak të situatës nga COVID-19, komisioni pak ka mundur të bëjnë lëvizje në vendet e tjera. Ajo njoftoi se sa i përket politikës së jashtme ka një unitet në mes të deputetëve dhe se qëndrimi i tyre është që të mbrojnë interesin e Kosovës. Zvarritja e liberalizimit të vizave, theksoi se është një padrejtësi që po i bëhet Kosovës. Ajo njoftoi se në një takim që kanë pasur me shefin e BE-së është thënë se ndoshta lufta në Ukrainë e ka sensibilizuar Evropën dhe është arritur njëfarë konsensusi në përafrimin e qëndrimeve në mes të vendeve të Evropës. Kadrijaj bëri me dije se në këtë takim është kërkuar që të gjitha kërkesat e parashtruara nga ne të përkrahen, por se nuk ka diçka konkrete. Në raport me këtë, tha se edhe ne duhet plotësuar obligimet tona, dhe se është e rëndësishme që Qeveria të sjellë në Kuvend për miratim, strategjinë për mbrojtje. Sa i përket dialogut, tha se dialogu duhet të kalohet nga ai teknik në një marrëveshje përfundimtare, me njohje reciproke, respektim të kufijve, ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës.

Anton Quni, takimin e përbashkët mes dy komisioneve e vlerësoi pozitiv, duke treguar një vëmendje pas agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës. Sa i përket mundësisë së Kosovës për t'u anëtarësuar në NATO, anëtarësimi nuk është çështje ekskluzive e ushtrisë, por e Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Jashtme. Ndër kriteret që duhet plotësuar është fqinjësia e mirë, ndërkaq do të duhet edhe përfundimi i dialogut me Serbinë, ndërkaq status quo nuk i shërben Kosovës, gjë që u tha edhe nga vizita e zyrtarëve të lartë të SHBA-së. Aspekt tjetër është aftësia për të marrë pjesë në misionet, çështje tjetër që vlerësohet është siguria e informacionit, për këtë arsye duhet të punohet shumë në këtë drejtim. Gjithashtu aspekt tjetër është legjislacioni i Kosovës, i cili duhet të jetë kompatibil me atë të NATO-s, siç është kontrolli demokratik dhe civil, llogaridhënia, përgjegjësia etj. Qeveria e Kosovës duhet të punojë bashkë me palët e interesit të hartojë strategjinë nacionale dhe më pas strategjinë e mbrojtjes.

Fatmir Humolli, duke iu referuar zhvillimeve aktuale, vlerësoi që Kosova duhet të ketë një institut shkencor, që analizon si ka qenë, si është dhe si duhet të jetë Kosova, në mënyrë që mos të jemi të papërgatitur, pasi nuk duhet parë gjërat në prizmin e ngushtë të një partie, pasi aspekti i sigurisë është shumë i rëndësishëm dhe duhet investuar në të. Tutje theksoi se duke qenë se Rezoluta 1244 është ende në fuqi, shteti fqinj do të përdorë këtë element për të ndikuar në fushën e sigurisë, andaj duhet punuar në këtë drejtim.

Enver Dugolli, duke iu referuar që nga disa anëtarë të Komisionit u përmend Fondi i Sigurisë, por ky fond nuk e pengon anëtarësimin e Kosovës në mekanizma të tjerë, pasi qytetari me vullnetin e tij kontribuon, njëjtë edhe shtetet e caktuara kanë ofruar mbështetje për krijimin e kapaciteteve.

Xhavit Haliti, tha se është dakord me diskutimet për nevojat dhe domosdoshmërinë që ka Kosova për t'u integruar në mekanizmat ndërkombëtar, qofshin politikë dhe ushtarak. Impenjimi i Kosovës në raport me Ukrainën, tha se ka qenë jashtë mase i mirë, por mundësitë kanë qenë dhe janë të kufizuara. Lidhur me lobimin bëri të ditur se në 20 vitet e fundit është lobuar dhe lobimi është duke ndodhur edhe tani, dhe se institucionet e Kosovës, shoqëria civile dhe mediat janë të impenjuara për ta integruar Kosovën në këta mekanizma. Ai shtoi se Kosova nuk është duke i analizuar pengesat në raport me katër shtetet që janë në NATO dhe me pesë shtetet e BE-së të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Institucionet e Kosovës nuk janë duke folur hapur me popullin dhe se populli po pompohet me deklarata patriotike që nuk i hyjnë në punë askujt përveç interesave elektorale. Duke iu referuar

diskutimit të deputetit Fatmir Humolli, lidhur me armatosjen, Haliti tha se, kur e kanë takuar z. Clark gjatë luftës ia kanë kërkuar këtë gjë, mirëpo përgjigja e tij ka qenë se ju keni miq të cilët do t'ju armatosin. Lidhur me këtë shtoi se ka qenë fat i mirë që nuk kemi pritur të armatosemi, por ata e kanë kryer punën e tyre nga lartë e në punën tonë. Sa i përket Fondit të Sigurisë, z. Haliti tha se çdo fond duhet të jetë transparent dhe duhet ta ketë një statut të miratuar dhe pastaj të kalojë në sistemin bankar. Ai shtoi se duhet të dihet se për çfarë do të përdoren ato mjete, kush është komisioni mbikëqyrës i atij fondi dhe se a i lejohet Kosovës të krijojë forca të përmasave që pretendohet publikisht në kushtet kur NATO-ja garanton sigurinë në Kosovë.

Sa i përket financimit të ushtrisë, tha se është mirë që të shikohet edhe përvoja e shteteve tjera të cilat e financojnë ushtrinë përmes taksave, gjë që mund të bëhet edhe në Kosovë.

Sa i përket situatës në veri, Haliti tha se kjo çështje nuk është aq e thjeshtë, siç po deklarohet dhe se ka probleme, por se duhet të merremi vesh për t'i përfunduar ato.

Hisen Berisha, duke iu referuar deklarimeve për zhvillimet në politikën e jashtme dhe në vend, sa i përket zhvillimeve në veri të vendit, tha se Qeveria duhet të ketë qëndrim, pasi nëse nuk mundet policia ka edhe mekanizma të tjerë. Ndërsa sa i përket Fondit për Siguri, është e nevojshme, por nuk duhet lejuar që partnerët që monitorojnë të mos deklarohen se nisma të tilla mund të jenë komprometuese.

Haki Abazi, shprehu mendimin që në pjesën e dytë të takimit, diskutimi duhet të thellohet në atë se tashmë ka një alarm pozitiv prej anëtarëve të NATO-s për një vështrim ndryshe ndaj Ballkanit Perëndimor dhe se institucionet, pozita dhe opozita duhet të jenë të gatshëm t'i përgjigjen kësaj situatë të re. Lidhur me situatën në veri, Abazi tha se Kryeministri dhe ministri i Punëve të Brendshme qysh në ditën e dytë të sulmeve kanë bërë të ditur se ka qenë fatmirësi që policët kanë qenë në automjete të blinduara dhe rrjedhimisht nuk janë lënduar, që nuk është zvogëlim i problemit. Ai më tej shtoi se duhet të jemi të kujdesshëm me kualifikimet për shkak se institucionet mund të vendosen në situata të papritura.

Abazi bëri të ditur se askush në asnjë formë nuk len pa e dënuar sulmin ndaj sektorit të sigurisë, sidomos kur ato vijnë si të paprovokuara, por e dimë që Serbia ka bërë skenarë edhe në të kaluarën dhe mund të bëjë edhe tani. Nuk ka pikëvështrime të ndryshme sa i përket asaj se çfarë në fakt është Serbia, e cila ka dal edhe kundër sanksioneve të BE-së, dhe është e radhitur në anën e agresorit në Ukrainë.

Për Fondin e Sigurisë, tha se kërkesa për transparencë e llogaridhënie është e drejtë dhe institucionet janë të detyruara që në bazë të Ligji për qasje në dokumentet zyrtare të sigurojnë transparencë në mënyrë që të eliminohen të gjitha paqartësitë.

Kryetari konstatoi se komisioni vendosi që më tej, mbledhja të vazhdojë me dyer të mbyllura.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisioneve.

Haki Abazi,
Kryetar i Komisionit